

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, sipas gjyqtarit, Halil Zahiri, me s. juridike, Shefinaz Sahiti, në çështjen juridiko-civile të paditësit, H.H, nga Gj, , ndaj të paditurit, R. K, nga Gj, , tani në në adresë të panjohur, përkohësisht i përfaqësuar prej av. G.S nga Gj, për vërtetimin e të drejtës së pronarisë, në seancën kryesore dhe publike të mbajtur më dt.18.07.2017 bie këtë

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkespadia e H.H nga Gj, ndaj të paditurit, R. K, nga Gj.tani në adresë të panjohur, **VËRTETOHET** se paditësi, në bazë të veprimit juridik, kontratës verbale për shitblerjen e pasurisë së paluajtëshme dhe mbajtjes me mirbesim të ligjshëm është pronar i pasurisë së paluajtëshme përkatësisht ngas.kad.nr..., në sipërfaqe prej gjithsejt ..ha, me kulturë, shtëpia nga lindja në sipërfaqe prej 73 m2, shtëpia nga përendimi në sipërfaqe prej 83 m2, kuzhina verore në sipërfaqe prej 32 m2 dhe oborr në sipërfaqe prej 0.03,61 ha, e cila gjendet në v.q. ,, e regjistruar në emër të të paditurit, sipas Çertifikatës nga lënda nr..., ZK Gj, e lëshuar më dt.20.04.2017, nga DGJKP, në Gj dhe **DETYROHET**, i padituri t ia njohin dhe pranojnë paditësit të drejtën e pronësisë për pasurinë e paluajtëshme kontestuese, në bazë të veprimit juridik, kontratës verbale mbi shitblerjen e pasurisë së paluajtëshme dhe mbajtjes me mirëbesim, të ligjshëm.

II. REKOMANDOHET, DGJKP, në Gjilan ta regjistroi paditësin, si pronar juridik për pasurinë e paluajtëshme të cekur në pik. I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, këtë në afat prej 15 ditësh, pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me vërejtje të përmbarimit të detyruar.

III. Në bazë të nenit 450 të LPK-ës, gjykata vendosi, sejcila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi, H.H, nga Gj, me padinë të ushtruar më dt., kësaj gjykate, kishte konfirmuar, në bazë të veprimit juridik, Kontratës verbale për shitblerjen e pasurisë së paluajtëshme në vitin 1970, e kishte bler prej të paditurit, R.K, nga Gj, tani në adresë të panjohur, pasurinë e paluajtëshme kontestuese, të cekur si në padi, për çmimin kontraktues, në lartësi prej 10.000.000, /dhjet miloin/ Dinar, blerësi pasi e ka paguar çmimin kontraktues, i padituri ia kan dorëzuar paditësit, pasurinë e paluajtëshme dhe çelësat e shtëpisë së vjetër, në shfrytëzim të papenguar nga i padituri, familjarët e tij apo megjenikët.

Në mes palëve kontraktuese ishin përmbushur detyrimet kontraktuese e tani paditësi pasurinë kontestuese e kan në posedim dhe shfrytëzim të papenguar nga i padituri, familjarët e tij apo megjenikët.

Në seancën kryesore të mbajtur më dt.18.07.2017, paditësi, H.Ha, nga Gj, deklaroi se në tërësi qëndroi pran padisë-kërkespadisë, i propozoi gjyqtarit të çështjes, të dalin me ekspert gjeodet në vendin e ngjarjes me palët ndërgjyqëse për ta identifikuar pasurinë kontestuese, të dëgjohet eksperti gjeodet, të dëgjohet dëshmitari i propozuar, të administrohen të gjitha provat

nga lënda dhe pas vërtetimit të gjendjes faktike, gjykata të bie aktgjykim me të cilin do ta aprovoi në tërësi kërkespandinë e paditësit si të bazuar.

Përfaqësuesi i përkohëshëm av. G. S, nga Gj, në emër të të paditurit, R. K, nga Gj, tani në adresë të panjohur, deklaroi se qëndroi pran përgjigjes në padi, pajtohem me propozimin e palës paditëse, se gjyqtari i çështjes të dalin me ekspert gjeodet në vendin e ngjarjes për të shiquar gjendjen faktike, të dëgjohen eksperti gjeodet, dëshmitari i propozuar, pas administrimit të provave dhe vërtetimit të gjendjes faktike, e rezervoi të drejtën të deklarohem lidhur me zgjidhjen e çështjes kontestuese.

Në seancën kryesore të mbajtur më dt.18.07.2017, gjykata i ka dëgjuar ekspertin gjeodet dhe dëshmitarin e propozuar si vijoi:

1. Eksperti gjeodet I.J. deklaroi, qëndroi në tërësi pran konstatimit me skicë të hartuar nga vendi i ngjarjes dhe konfirmoi se sipërfaqja e ngas.kad.nr. ..., nga gjendja aktuale në teren përputhet plotësisht me çertifikatën e pronës dhe të dhënat nga Elaborati kadastral, në DGJKP, në Gjilan dhe jam i gatshëm të përgjigjem në pyetjet e gjyqtarit dhe palëve ndërgjyqëse.

Në pyetjen e gjyqtarit eksperti gjeodet deklaroi gjendja faktike e ngas.kad.nr. P.70403013-3467-0, është në sipërfaqe prej gjithësejt 0.05,59 ha, me kulturë, shtëpia nga lindja në sipërfaqe prej 73 m2, shtëpia nga përendimi në sipërfaqe prej 83 m2, kuzhina verore në sipërfaqe prej 32 m2 dhe oborri në sipërfaqe prej 0.03,61 ha, e cila gjendet në v.q. „rr. Avdulla Presheva/ Varosh,, në Gjilan.

2. Dëshmiatri, R. R. nga Gj deklaroi, me përgjegjësi morale, materiale dhe penale nën betim deklaroi, se paditësi, , në vitin 1970, e ka bler pasurinë e paluajtëshme kontestuese, prej të paditurit, , nga Gjilani, tani në adresë të panjohur, për çmimin kontraktues në Dinar të atëhershëm, sa para nuk më kujtohet, kam prezentuar kur është kryer shitblerja, kur jan përmbushur detyrimet kontraktuese, kur ia ka dorëzuar blerësi shitësit parat, ndërsa shitësi ia ka dorëzuar çelësat dhe pronën blerslit në shfrytëzim dhe posedim, ndërsa patët kontraktuese njëri - tjetrit ia kan uruar pazarin e arritur.

E njoftoi gjykatën se pasi jan përmbushur detyrimet kontraktuese, paditësi nga viti 1970 e deri më tani, e mabnë dhe e ka në shfrytëzim pasurinë kontestuese si pronar faktik i pa penguar nga i padituri, familja e tij, personat e tretë apo megjenikët.

Në bazë të nenit 8 të LPK-ës, gjykata i ka analizuar deklaratat e palëve ndërgjyqëse, ekspertit, dëshmitarit dhe i ka administruar të gjitha provat nga lënda si vijon;

- Lexohet dhe administrohet, Çertifikata sipas lëndës nr..., e lëshuar më dt...., prej DGJKP, në Gj. Nga kjo provë gjykata konstatoi se ngas.kad.nr. P-70403013-03467-0, në sipërfaqe prej 0.05,59 ha, ishte e regjistruar në emër të të paditurit, Ramiz /Islam/ Krasniqi, nga Gjilani.

- Lexohet dhe administrohet, Vërtetimi i dt.18.10.2013,, mbi tatimpaguesin, H. H, nga Gjilani.

- Lexohet dhe administrohet, Fatura e pagesës së energjisë elektrike, e dt.13.09.2015, në emër të H. H, nga Gj.

- Lexohet dhe administrohet, Fatura e pagesës së ujit, e dt.13.09.2015, në emër të H. H, nga Gj.

- Lexohet dhe administrohet, Fatura e pagesës së hedhurinave, e dt.29.07.2013, në emër të H.H, nga Gj.

- Lexohet dhe administrohet, Letërnjoftimi, në emër të H. H, nga Gj.

- Lexohet dhe administrohet, Çertifikata sipas lëndës nr... e lëshuar më dt.20.04.2017, prej DGJKP, në Gjiilan. Nga kjo provë gjykata konstatoi se ngas.kad.nr. P-70403013-03467-0, në sipërfaqe prej ...ishte e regjistruar në emër të të paditurit, Ramiz /Islam/ Krasniqi, nga Gjiilani.

- Lexohet dhe administrohet, Konstatimi me skicën e hartuar nga vendi i ngjarje më dt.04.07.2017, prej ekspertit gjeodet, I.J, nga Gji. Nga kjo provë gjykata konstatoi se pasuria kontestuese e ka sipërfaqen e njejt në raport me të dhënat nga Çertifikata e pronës dhe të dhënat nga Elaborati Kadastral, prej DGJKP, në Gjiilan.

Në fjalën përfundimtare, paditësi H..Ha, deklaroi se nga provat e administruara, dëgjimit të ekspertit gjeodet, dëshmitarit, gjykata e ka konstatuar gjendjen faktike se ka ekzistuar raporti juridiko-material në mes palëve kontraktuese se pasurinë kontstuese paditësi në vitin 1970 e ka blerë, nga i padituri, ndërsa paditësi e ka në shfrytëzim dhe posedim si pronare faktik, i pa penguar nga i padituri, familjarët dhe megjenikët, e shfrytëzon mbi 20 vite, i propozoi gjykatës se nga baza të shitblerjes dhe nga baza e parashkrimit fitues në mbajtje të ligjëm dhe me mirëbesim të vendos në bazë të Ligjit me aktgjykim meritor dhe ta vërtetoi kërkespadinë e paditësve si të bazuar. Nuk i kërkoi shpenzimet e procedurës.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit, av..., në emër të të paditurit, R. K, nga Gj, tani në adresë të panjohur, në fjalën përfundimtare deklaroi, në bazë të provave të administruara në seancën e kryesore, dëgjimit të ekspertit gjeodet dhe dëshmitarit, është vërtetuar gjendja faktike, andaj i propozoi gjykatës lidhur me zgjidhjen e çështjes kontestuese të vendos sipas Ligjit, me aktgjykim meritor. I kërkoi shpenzimet e procedurës sipas T.A.

Nga të cekurat më lart gjykata e vërtetoi gjendjen faktike dhe konstatoi se paditësi si pronar faktik e shfrytëzon pasurinë kontestuese, ndërsa në anën tjetër konstatohet se ka ekzistuar raporti materialo-juridiko mes paditësit dhe të paditurit sipas veprimit juridik kontratës verbale për shitblerjen e pasurisë së paluajtëshme dhe gjykata në bazë të nenit 73 të LMD-ës, e konvalidoi kontratën verbale me shkrim për shitblerjen e pasurisë së paluajtëshme.

Gjykata në bazë të nenit 28 të LTHMP konstatoi se paditësi mbi 20 vite e mban pasurinë kontestuese, e ka në shfrytëzim të ligjshëm me mirëbesim, i pa penguar nga i padituri, familja e tijë apo personat tjerë dhe nga baza e shitblerjes dhe prashkrimit fitues paditësit iu ka vërtetuar e drejta pronësisë për pasurinë e paluajtëshme kontestuese.

Nga të cekurat më lart, në bazë nenit 73 të LMD-ës, nenit 28 të LTHMJP, nenit 143 par.1, të LPK-ës, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Në bazë të nenit 450 të LPK-ës, sejcila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Gjyqtari
Halil Zahiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të të njejtit. Ankesa dorëzohet në kopje mjaftuara përmes kësaj Gjykate.

